

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mire Beqiraj procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit: R. M. nga fshati L. KK Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1594/14, të datës 30.12.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren - departamenti i përgjithshëm Sahide Sefa, dhe të akuzuarit, me datë 09.06.2017, publikisht mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

R. M. nga i ati Y. e ëma S. e lindur R., i lindur me datë , nga fshati L. - Prizren, ku dhe tani jeton, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa punë, analfabet, rom, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Se prej datës 20.06.2014, rreth orës 12:30 në Prizren, në rrugën " " nr. , me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personit tjetër, merr pasurinë e luajtshme dhe atë patikate të dëmtuarit A K në atë mënyrë që shkon në ndërtesën banesore kinse për të shitur fleta hardhie, i merr patikat e të dëmtuarit nga korridori, i fut në çantë dhe ik nga vendi i ngjarjes.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 parag. 1, të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 27, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 73, nenit 321 parag. 1 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **200(dyqindë) € euro**, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet edhe me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do të caktohet një ditë burgim, përkatësisht 10 (dhjetë) ditë burg.

Pala e dëmtuar KEDS-u distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PPII.nr. 1594/14, të datës 30.12.2014, kundër të akuzuarit: R. M. nga fshati L. KK Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 të KP-së.

Në shqyrtimin fillestar i akuzuari R. M. ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH- së.

Bazuar në pranimin e fajësis, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari R. M., se prej datës 20.06.2014, rreth orës 12:30 në Prizren, në rrugën " " nr., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personit tjetër, merr pasurinë e luajtshme dhe atë patikate të dëmtuarit A.K., në atë mënyrë që shkon në ndërtesën banesore kinse për të shitur fleta hardhie, i merr patikat e të dëmtuarit nga korridori, i fut në çantë dhe ik nga vendi i ngjarjes.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht është paraqitur në gjykatë dhe ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësis nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë dhe dënimin me kusht, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, nuk ka gjetur rrethana rënduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, gjer më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, është njeri familjar, i gjendjes së dobët ekonomike materjale, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) euro, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarëve në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marë konform nenit 463 par.1 e 2 të KPP.


Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2030/14, të datës 09.06.2017

Sekretare Juridike
Mire Beqiraj

Gjyqtari
Gani Kastrati



Gani Kastrati

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palë e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.